



Prishtinë: 27.05.2009
Kodi i ZRRE-së: V_181_2009

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
3. Nenit 16 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
4. Kërkesën e KOSTT SH.A të datës 28 janar 2009, dhe kërkesën e datës 04 maj 2009 për aprovimin e dokumentit “Monitorimi i Pajtueshmërisë për Indikatorët e Performancës Teknike” dhe “Propozimi për Indikatorët Minimal të Performancës Teknike” ,në seancën e mbajtur më 27 maj 2009 ka nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Aprovohet** dokumenti “**Procedura e Monitorimit të Pajtueshmërisë për Indikatorët e Performancës Teknike**” si në Shtojcën 1 të këtij vendimi.
2. **Aprovohet** dokumenti “**Propozimi për Indikatorët Minimal të Performancës Teknike**” si në Shtojcën 2 të këtij vendimi.

ARSYETIM

1. ZRRE me datë 28 janar 2009 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit “**Monitorimi i Pajtueshmërisë për Indikatorët e Performancës Teknike**”. Po ashtu, pas vërejtjeve të bëra, me datën 04 maj 2009 ZRRE ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A për aprovimin e këtij dokumentit të përpunuar duke i shtuar edhe dokumentin “Propozimi për Indikatorët Minimal të Performancës Teknike”
2. Pas vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh përmbajtjen e dokumenteve të cilat i përgjigjen kërkesave sipas dokumentit të aprovuar “**Indikatorët Teknik të Performancës**” dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale të sistemit të transmisionit ka parë të arsyeshme që të aprovoj dokumentet si në shtojcën 1 dhe shtojcën 2 të këtij vendimi.



3. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e nxjerrjes së tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund të iniciojnë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e fundit.

Këtij vendimi i bashkëngjiten këto dokumente:

1. Shtojca 1 - **Monitorimi i Pajtushmërisë për Indikatorët e Performancës Teknike**
2. Shtojca 2 - **Propozimi për Indikatorët Minimal të Performancës Teknike**
3. Shtojca - **Kërkesa e KOSTT-it;**

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar